

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Nebojša Boričić, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurve: S.B., F.K., F.K1, F.K2, M.K., A.N. dhe G.U., për shkak të veprave penale: kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve F.K. dhe F.K1, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.405/2016 të datës 6.3.2017, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.516/2017 të datës 15.3.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 5.4.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e pjeshëm të kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve F.K. dhe F.K1, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.405/2016 i datës 6.3.2017, dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.516/2017 i datës 15.3.2017, ndryshohet ashtu që ndaj të pandehurve ndërpritet masa e paraburgimi dhe caktohet masa e arrestit shtëpiak. Të pandehurve F.K. dhe F.K1, masa e arrestit shtëpiak do t'i zgjasë deri më datë 7.5.2017.

II. Të pandehurit nuk guxojnë të largohen nga shtëpitë e tyre, të pandehurit F.K. dhe F.K1 në Prishtinë, pa lejen e gjykatës.

III. Obligohet Stacioni Policor më i afërt që të bëjë zbatimin, mbikëqyrjen dhe verifikimin e masës.

IV. Gjykata mund të caktojë paraburgimin nëse të pandehurit nuk e respektojnë këtë aktgjykim.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i krimeve të rënda, me aktvendimin PKR.nr.405/2016 e datës 6.3.2017, të pandehurve F.K. dhe F.K1, për shkak të veprës penale; veprave penale; kontrabandim me migrantë nga neni 170 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, iu ka vazhduar masën e paraburgimit

në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaji, i cili do të zgjasë deri më datë 7.5.2017, konform nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ndërsa të pandehurve S.B., F.K2, M.K., A.N. dhe G.U., u ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaji, e cila masë do t'iu zgjasë deri më datë 7.5.2017.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.516/2017 e datës 15.03.2017, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar: mbrojtësi i të pandehurit F.K., av. L.B.Y., dhe mbrojtësi i të pandehurit F.K1, av.B.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të KPPK, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar dhe të ndryshohen aktvendimet e kundërshtuara, ashtu që paraburgimi ndaj të pandehurve të ndërpritet dhe ti zëvendësohet me ndonjërin prej masave tjera alternative.

Në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit F.K., thekson se gjykata e shkallës së parë ka përdorur standarde të dyfishta kundër të pandehurve tjerë me që gjykata për të pandehurit F.K. dhe F.K1, konsideron se po të gjenden në liri mund të pengojnë zhvillimin e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarët, ndërsa në anën tjetër në arsyetimin e caktimit të masës tjetër ndaj të akuzuarve tjerë e mbështet faktin se deri sa të njëjtit do të vazhdojnë të qëndrojnë të mbyllur në shtëpi nuk mund të ndikojnë në dëshmitarët tjerë, se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme se i pandehuri ka kryer veprat penale, se pesha e veprës penale nuk do të duhet të ishte asnjëherë rrethanë për caktimin - vazhdimin e paraburgimit, se të pandehurit i dihet vendbanimi dhe premtion se nuk do ta braktis vendbanimin.

Mbrojtësi i të pandehurit F.K1, thekson se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë as edhe një fakt të vetëm të arsyetuar se për çka të pandehurit i është vazhduar paraburgimi, se kohëzgjatje e paraburgimit në procedurë penale duhet zvogëluar në kohë sa më të shkurt të mundshme, se nga praktika gjyqësore kemi raste kur edhe për vepra më të rënda penale kemi aplikimin e masave më të buta se sa paraburgimi, se prokurori ka marrë në pyetje të pandehurin dhe i njëjti ka deklaruar se nuk ka të bëjë fare me veprat penale për të cilat dyshohet, andaj edhe konsideron se kanë pushuar shkaqet e vazhdimin të mbajtjes së paraburgimit.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.19/2016 e datës 3.4.2017, ka propozuar që të refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruara nga mbrojtësit e të pandehurve.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë gjeti se:

- Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë pjesërisht të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësve të të pandehurve, se në rastin konkret nuk është i arsyeshëm caktimi i paraburgimit ndaj të pandehurve, si masë më e rëndë për sigurimin e prezencës së të pandehurve në procedurë penale, edhe pse ekzistojnë kushtet të parapara me nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa masa e paraburgimi caktohet vetëm nëse asnjë nga masat alternative nuk mund të jenë efektive në aspektin e parandalimit të përsëritjes së veprës penale, dhe zhvillimit të pa penguar të procesit penal, e që një situatë e tillë në rastin konkret, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk ekziston.

Bazuar në këtë Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që masën e paraburgimit tia zëvendësoi më masën e arrestit shtëpiake duke i urdhëruar dhe ndaluar të pandehurit që të mos largohet nga shtëpia e tyre, e cila gjendet në Prishtinë, ndërsa përjashtimisht të pandehurit mund të largohen nga shtëpia e tyre vetëm në raste të domosdoshme për përmbushjen e nevojave jetësore respektivisht mjekësore apo kryerjen e ndonjë pune me rëndësi, mirëpo së pari për këtë duhet kërkuar leja e gjykatës.

Të pandehurit paralajmërohen se në rast se pa leje e shkelin këtë masë ndaj tyre gjykata mund të caktojë paraburgimin. Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase do ta bëjë policia.

Për arsyet e përshkruara më sipër, kjo Gjykatë pjesërisht aprovoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe në kuptim të nenit 438 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.79/2017, më datë 5.4.2017

B.Profesionale,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa